



## MBRËMËSORE

Der' e Bukur hapet, Prifti qëndron përpara Alltarit me Temianicën dhe Diaku me birinë.

DIAKU nis :

Ngre-u, ô Zot, bekô.

Dhe PRIFTI thotë :

Lavdî Trinisë së Shëntë, së Bashkëqënurshme, Jetëdhënëse dhe së Pandarë, për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve.

VALLEJA përgjigjet :

Amen.

Prifti temianis tërë Kishën dhe njerëzinë kur këndohet Psalmi Nisëtor (104), dhe pasi mbaron së temianisuri qëndron përpara Derës së Bukur karos dhe thotë pshehtazi: Urimet e Dritës.

KËNDONJËSI thotë :

Ejani t' i falemi e t' i biem nër këmbë Perëndisë, Mbretit tonë.

Ejani t' i falemi e t' i biem nër këmbë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë.

Ejani t' i falemi e t' i biem nër këmbë vetë Krish-tit, Perëndisë dhe Mbretit tonë.

PSALM 104.

Bekô Zotin, ô shpirti im. O Zot, Perëndia ime, fort tepër u-madhove ; je veshur me nder e me madhë-

rî. Ti që heth përmi vetëhe dritën posi robë ; ti që shtrin qiellin posi kurtinë : Ay që ndërton dhomat e tija të lartat nd' ujërat : bën retë qerret e tij dhe ecën mi fletët e erës : Bën ëngjëjt' e tij frymëra dhe meshëtarët e tij flagë prej ziarri.

Ay që qëndroj dhenë mi themelit' e saj që të mos tundet jetë pas jete. E mbulove me avushën, posi me robë : ujërat qëndruan mi malet. Prej qërtimit tënt iknë : prej zërit të bubullimës s'ate u-hoqnë me nxitim : Hipnë mi malet, zbritnë ndë fushat, n' atë vënt që i themelove. Vure kufi që nuk do t'a kapër-xejnë, as do të kthehen për të mbuluar dhenë. Ay që dërgon burime nër përrënjtë që të shkojnë për mes maleve : Pinë ujë gjith' egërsirat e fushës : gomarët e egër shuajnë etjen e tyre : Pranë atyre kanë të ndënjurit shpest' e qiellit, edhe apin zë në mes të degave. Ay vadit malet prej vëndeve të tij të larta : dheu nginjet nga pemët e punëve të tua. Ay që bën të mbijë bar për bagëtinë, dhe barishtë për shërbimin e njerësve, që të nxierë bukë prej dheut ; edhe verë që gëzon zëmërën e njeriut, vaj për të ndritur faqen dhe bukë që forcon zëmërën e njeriut. U-nginjnë drut' e Zotit : dëllinjat e Libanit që mbolli : Atje ku bëjnë folë zoqtë : sa për shtërkun, bredhat janë ndënjia e tij. Malet e lartë për dhit' e egëra ; gurët janë pështetje për lepurat.

Bëre hënë për motet : dielli njeh të perënduarit e tij. Lëshon errësirë e bëhet natë ; n' atë shkojnë gjith' egërsirat e pyllit. Këlyshët e luanëve ulërijnë

për të rrëmbyer, e për të lypur prej Perëndisë ushqimin e tyre : Len dielli ; hiqen më nj' anë edhe bien e flenë ndëpër shtrofkat e tyre : Del njeriu në punën e tij dhe në mundimin e tij gjer mbrëmanet.

Sa u-madhuan punët e tua, ô Zot! të gjitha i bëre me urtësî ; dheu është plot me kriesat e tua : Ay det i math e i gjerë ; atje janë shtërpënj që s' kanë numër, shtaza të vogëla bashkë me të mëdha : Atje shkojnë lundra : atje është Leviathani që krijove për të luajtur ndë të. Gjithë këtë shpërej në më ty që t' u apësh ushqimin më kohë. Atë që u ep, e mbledhin ; ti hap dorën, atô nginjen së mirash : Ti kthen faqen më nj' anë, atô përzihen : u ngre frymën, shuhen, edhe kthehen në baltë të tyre : U dërgon frymën tënde ; ndërtohen, edhe përsërit faqen e dheut.

Qoftë lavdi' e Zotit për gjithë jetën : u-gëzoftë Zoti për punët e tija. Ay që shtie sytë mi dhet, edhe dridhet : ayprek malet, edhe nxierin tym. Do t' i këndoj Zotit sa të rroj ; do t' i psall Perëndisë s' ime sa të jem. Mëndimi qoftë i ëmbël përpara tij : unë do t' gëzohem për Zotin. U-shofshin fajtorët prej dheut edhe të paudhët mos qofshin më. Bekô Zotin, ô shpirti im. (Prapë.) Dielli njeh të përnduarit e tij. Lëshon errësirë e bëhet natë.

Sa u-madhuan punët e tua, ô Zot ! të gjitha i bëre me urtësî.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Alleluia, alleluia, alleluia, lavdî ty ô Perëndi  
(*tri herë*), ô Zot, shpresa jonë, lavdî më ty.

Passi mbarohet Psalmi Nisëtor, thotë Litanin' e madhe  
DIAKU, ose në mos pastë, PRIFTI :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Për paqjen që lartazi...

(Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, taní e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Pastaj këndohet Kathism' e parë e Psalterit « Lum' ay njeri ».

Pas Kathismës thohet Litani' e Vogël.

Përsëri dhe përsëri, më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Përkrah-na, shëptô-na... (Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se jotja është lart-madhësia, dhe jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, taní e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Pastaj këndohen *Thirrëtoret* me Troparet e tyre të ditës, pas Tingëllit që të goditë; në këtë mes, Diaku merr temianicën dhe, pasi kërkon bekimin e Priftit, temianis Shëntëroren dhe Kishën.

VALLET këndojnë : Psalm 141.

O Zot, thirra te ty, dëgjô-më, dëgjô-më, ô Zot.  
O Zot, thirra te ty, dëgjô-më, vër re zën' e lutjes s' ime; më të thirrurit t' im te ty, ô Zot, dëgjô-më.

Le të vijë falja ime përpara teje si temian, dhe ngritja e duarve të mia si therore e mbrëmëshmë. Dëgjô-më, ô Zot.

Vër ruajtje në gojë t' ime, ô Zot : ruaj derën e buzëve të mia.

Mos përvar zëmërën t' ime më fialë të këqia që të vepëroj punë të këqia.

Bashkë me njerës që punojnë paudhësí; dhe do t' mos ha nga gjellët e zgjedhura të tyre.

Le t' më mendojë i drejti me përdëllim dhe do t' më qërtojë; po vaj mëkatari mos leftë kryet t' im.

Se, edhe kur të jenë ndë të keq, do të falem për

tâ. Gjykatësit e atyre, kur të hidhen në gurishta.

Do t' dëgjojnë fjalët e mia, se janë t' ëmbla. Eshtërat tona janë përndarë ndë gojë të Ferrit, sikur ndonjë lëron e çan dhenë.

Përandaj syt' e mî janë më ty, ô Zot Perëndî ; më ty shpëreva, mos ler shpirtin t' im të shkretë.

Ruaj-më prej kurthit, që ngritnë për mua dhe nga shkandullat e atyre që punojnë paudhësi.

Fajtorët rënçin në rietat e tyre, kur të shkoj unë m' at' anë.

## PSALM 142.

Me zënë t' im thërres më Zotin ; me zënë t' im i lutem Zotit.

Do të derth lutjen t' ime përpara tij ; do t' dëftoj hidhërimin t' im përpara tij.

Kur m' u-zû fryma, atëhere ti njohe udhët e mia.

Më udhën që barisnja, fshehnë kurth për mua.

Vështronja më të diathtë dhe shëkonja, dhe s' kish nonjë që të më njohë.

Mpshtetja humbi prej meje, s' ka ndonjë që të kërkojë shpirtin t' im.

Thirra më ty, ô Zot ; thashë : Ti je shpresa ime, piesa ime te dheu i të gjallëve

Mbaj-i vesh lutjes s' ime, se u-përunja fort tepër.

Shpëtô-më prej ndjekësve t' im, se janë më të fortë se unë.

VALLET këndojnë dhietë Tropare, duke u vënë përpara  
këtâ Vargje :

Nxir shpirtin t' im prej burgut që të lavdëroj  
emërin t' ënt.

Të drejtët do t' më kërkojnë kur të më bësh të  
mirë.

## PSALM 130.

Prej së thellash klitha më ty, ô Zot ; ô Zot, dëgjô  
zënë t' im.

Veshët e tû le t'i kenë kujdes zërit të lutjes  
s' ime.

Po të vësh re paudhësitë, ô Zot, ô Zot, kush  
munt të qëndrojë ? po pranë teje është ndjesa.

Për emërin tënt të prita, ô Zot ; shpirti im priti  
fialën tënde ; shpirti im shpëreu më Zotin.

Prej ruajtjes së mëngjazit gjer më natë ; prej  
ruajtjes së mëngjazit le të shpërejë Israeli më  
Zotin.

Se ka përdëllim te Zoti dhe shumicë çpërblimi ;  
dhe ay do t' çpërblejë Israelin prej tërë paudhësive  
të tij.

## PSALM 117.

Lavdëroni Zotin tërë kombet, nderojeni tërë  
popujt.

Se përdëllim' i tij u-fuqisua përmi ne, dhe e vërtet'  
e Zotit mbetet në jetë. — Lavdî, e tanî...

Kur këndohet Tropar' i fundit, Diaku merr Temianicën, del  
jashtë bashkë me Priftin nga der' e Veriut, me manalë përpara ;

dhe venë e qëndrojnë përpara Derës së Bukur. DIAKU, passi unjet, i thotë Priftit me zë të unjët :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë këtë  
Urim të Hyrjes :

Mbrëmane, dhe në mëngjest, dhe më drekë, të lëvdojmë, të bekojmë, të përhirojmë e të lutemi, ô Zot i gjithësisë. Drejtësoj-e faljen tonë si temian përpara teje, dhe mos i përvar zëmërat tona më fialë, a më mejtime ligësie, po shpëtô-na prej gjith' atyre që gjuajnë shpirtet tona ; se më ty janë kthyer sytë tanë, ô Zot, ô Zot, dhe më ty shpresuam ; mos na turpërô, ô Perëndia jonë. Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanë e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pas Urimit, DIAKU thotë :

Bekô, ô Zot, Hyrjen e Shëntë.

Dhe PRIFTI bekon nga Lindja, duke thënë :

E bekuar është Hyrja e Shëntorëve tënt, për gjithmonë, tanë e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU, passi mbarohet së-kënduari Tropar' i fundit, bën shënjën e kryqit me Temianicën dhe thotë :

Urtësî, ô të drejtë !



Hyjnë që të dy në Shëntëroren, Prifti dhe Diaku. Diaku temianis Alltarin e Shëntë.

VALLEJA këndon :

O Dritë gazmore e lavdisë së shëntë të Atit të pavdekshim, qiellor, të shëntë, e të lumur, Jesu Krisht. Me qerë që arrimë më perëndimin e diellit dhe shëkojmë dritën e mbrëmëshme, hymnojmë Atin, Birin, edhe Shpirtin Shënt, Perëndinë. Se të ka hie të hymnohesh më ç' do kohë me zëra të mbara, ô i bir' i Perëndisë, që fal jetë ; përanda j dhe bota të lavdëron.

DIAKU :

Parëvargu i Mbrëmës.

Në qoftë e Shtunë mbrëma, thohet kiô :

Zoti mbretëroj u-vesh me mirhiesî.

(Tri herë.) Prifti kthehet nga Perëndimi, me duartë të lidhura dhe qëndron duke pritur të mbarohet Parëvargu ; pastaj falet dhe vete më vëntt të tij. Pas Parëvargut, thotë *DIAKU* Litanin' e Gjerë :

Le të thomi të gjithë me gjithë shpirtin dhe me gjithë mëndjen tonë le të thomi.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë).

O Zot i tërëfuqishim, Perëndi e Atërve tanë...

(Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je Perëndi mëshirëplote dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit ..

VALLEJA :

Amen.

VALLEJA, ose PRELATI :

Vlerësô-na, ô Zot, këtë mbrëmë të ruhemi pa nonjë mëkatë.

I bekuar je, ô Zot, Perëndi' e Atërve tanë ; dhe emëri yt është i kënduar dhe i lavdëruar më jetët. Amen.

Le të jetë, ô Zot, përdëllimi yt mi ne, sikundër kemi shpresuar mi ty.

I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde.

I bekuar je, ô Zot, bë-më të mënçim me të drejtat tëndë.

I bekuar je, ô Shënt, ndriçô-më me të drejtat tënde.

Ty të ka hie lëvdatë, ty të ka hie hymnë, ty të ka hie lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, taní e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le t' i a mbarojmë faljen tonë të mbrëmëshme Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirë tënt.

Mbrëmën të tërë, të mbarë, të shëntë, të paqëshme dhe të pamëkatëshme, le t' i lypim Zotit.

VALLEJA :

Fal-na, ô Zot.  
Engjëll paqjeje,... (Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je l'erëndî e mirë dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdâ, Atit,...

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI :

Paqje mi ju te gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

DIAKU :

Krerët tanë le t' i a unjim Zotit.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

Urim' i Krye-unjtjes.  
PRIFTI e këndon fshehtazi.

O Zot, Perëndia jonë, që epe qiejtë dhe zbrate për shpëtimin e gjindjes së njerësve, hith synë mi shërbëtorët e tû dhe mi trashëgimin tënt. Se ty

Gjykatësit të trëmpshim e njerzidashës, t' i përunj-  
në krerët shërbëtorët e tû, dhe të subjektuan xver-  
qet e tyre ; duke mos pritur ndihmën që vien prej  
njerëzish, po përdëllimin dhe shpëtimin tënt, të cilët  
ruaj-i më ç' do kohë, dhe më këtë mbrëmë dhe më  
natën që vien, prej ç' do armiku, prej ç' do vepë-  
rimi kundrështar të diallit, prej mejtimesh të kotta,  
dhe prej kujtimesh të liga.

PRIFTI me zë të lartë :

Qoftë pushteti i mbretërisë s' ate i bekuar dhe i  
lavdëruar, i Atit,...

VALLEJA :

Amen.

Pastaj thohen Pasvargjet, pas të cilave thotë PRIFTI Kën-  
gën e Simeonit Hyjpritës :

Tani përlëshoj-e shërbëtorin tënt më paqje, pas  
fialës s' ate ; se syt' e mî panë shpëtimin tënt që pre-  
gatite përpara faqes së gjithë popujve ; dritë për të  
ndriçuar paganët dhe lavdî të popullit tënt Israel.

Pastaj :

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë,...

Trinî e Tërëshëntë...

Ati ynë...

PRIFTI :

Se jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia,  
e Atit, e Birit,...

VALLEJA :

Amen.

Pastaj thonë Troparet e ditës, dhe pas atyre PRIFTI bën Përlëshimin :

Bekim' i Zotit le të vijë mi ju, pas hirit dhe njerzidashjes së tij, për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Lavdâ ty, ô Krisht Perëndi, shpresa jonë, lavdâ më ty.

POPULLI :

Lavdâ Atit,... Tanî e përherë...

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë).

DIAKU :

Bekô, ô Atë.

PRIFTI :

Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, me nërmjetimet e Emes së tij së papërlyme e të Shëntë ; dhe të gjithë Shëntorëve, na mëshiroftë e na shpëtoftë si i mirë dhe njerzidashës. Amen.